



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 105**

**1 korrik**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 497, datë 21.6.2013	Për kalimin e sipërfaqes prej 300 m <sup>2</sup> , truall, pronë shtetërore, në pronësi të Myftinisë Tiranë, për ndjekjen e procedurave ligjore që nevojiten për ndërtimin e xhamisë “Selitë” .....	4631
Vendim i KM nr. 498, datë 30.5.2013	Për përcaktimin e procedurave të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës.....	4631
Udhëzim i METE nr. 8, datë 10.6.2013	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 1, datë 30.4.2012, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të aplikimeve për marrjen e lejeve ndërtimore për objekte të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe, si dhe për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e këtyre lejeve”, të ndryshuar.....	4638
Urdhër i MPTT nr. 88, datë 14.6.2013	Për miratimin e rregullores për autorizimet me kredenciale të inspektorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil.....	4639
Vendim i GJK nr. 26, datë 24.6.2013	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2012-1554, datë 28.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	4643
Vendim i GJK nr. 27, datë 24.6.2013	Me objekt: shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 00-2012-1593 (269), datë 24.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 00-2012-1593 (269), datë 24.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	4649

Vendim i GJK  
nr. 28, datë 25.6.2013

Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të  
rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një  
afati të arsyeshëm. .... 4656

Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Haxhire Shehu..... 4658

**VENDIM**  
**Nr. 497, datë 21.6.2013**

**PËR KALIMIN E SIPËRFAQES PREJ 300 M<sup>2</sup>, TRUALL, PRONË SHTETËRORE, NË  
PRONËSI TË MYFTINISË TIRANË, PËR NDJEKJEN E PROCEDURAVE LIGJORE QË  
NEVOJITEN PËR NDËRTIMIN E XHAMISË “SELITË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 4 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kalimin e sipërfaqes prej 300 (treqind) m<sup>2</sup>, truall e përfshirë brenda pronës me nr. pasurie 3/127, vol. 2, faqe 173, e ndodhur në zonën kadastrale 8240, në pronësi të Myftinisë Tiranë, me qëllim ndjekjen e procedurave ligjore që nevojiten për ndërtimin e xhamisë “Selitë”, për Komunitetin Mysliman Shqiptar.

2. Myftinisë Tiranë i ndalohet tjetërsimi apo dhënia në përdorim e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për qëllime të tjera, të ndryshme nga ndërtimi i xhamisë “Selitë”.

3. Çdo akt që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohet.

4. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 498, datë 30.5.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHËNJIMIT TË NAFTËS BRUTO DHE  
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 54 të ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

**1. Përkufizime**

Në kuptim të këtij vendimi, me termat dhe shprehjet e mëposhtme kuptojmë:

1.1 “Autoritet”, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

1.2 “Ditë punë”, një ditë gjatë së cilës kryhet puna në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të ditëve të pushimeve dhe festave zyrtare.

1.3 “Çmimi i shërbimit të shënjimit”, tarifa kombëtare e shërbimit të shënjimit, që do t’i paguhet koncesionarit nga subjektet e detyruara dhe do të jetë në shumën prej 614 (gjashtëqind e katërmëdhjetë) lekë plus TVSH-në, për 1000 (një mijë) litra të markuara.

1.4 “Direktivat e zbatimit”, specifikimet teknike që koncesionari paraqet si pjesë të Projektit dhe që miratohen nga autoriteti kontraktues së bashku me projektin, të cilat do t’i paraqiten dhe do të zbatohen nga subjektet e detyruara, për pjesën ku prekin aktivitetin e zhvilluar prej tyre.

1.5 “Koncesionari”, shoqëria koncesionare GFI Albania sh.p.k., e themeluar nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive Global Fluid International S.A. dhe Consulting Partners A.G, me



qëllim ofrimin e shërbimit të shënjimit, në përputhje me kontratën e koncesionit dhe me vendimin nr. 200, datë 13.3.2013 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive Global Fluids International s.a. dhe Petroleum Consulting Partners a.g.”.

1.6 “Kontrata e koncesionit”, kontrata e koncesionit “Për shërbimin e markimit dhe monitorimit” e lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave dhe koncesionarit.

1.7 “Shënjuesi”, shënjuesi Petromark™ i miratuar nga Këshilli i Ministrave me anë të kontratës së koncesionit dhe vendimit nr. 200, datë 13.3.2013 të Këshillit të Ministrave, i cili do të injektohet nga koncesionari në produktet e shënjimit duke bërë të mundur vërtetimin se produktet e shënjimit kanë shlyer detyrimet fiskale përkatëse, do të konsiderohet si shënjuesi kombëtar, dhe do të furnizohet dhe prodhohet vetëm nga koncesionari, i cili zotëron ekskluzivisht të drejtat e “*know-how*” për këtë produkt.

1.8 “Personeli i autorizuar”, personeli i koncesionarit, i caktuar nga ky i fundit për ta ndihmuar në instalimin, vënien në punë dhe zbatimin e shërbimit të shënjimit dhe për të përfaqësuar kompaninë.

1.9 “Produktet e shënjimit”, produktet e bardha (gazoil dhe benzen), produktet e zeza (solar dhe mazut), nafta bruto, lëndët djegëse dhe produktet e ndërmjetme e specifikuara produktet me emërtimet dhe kodet si vijon: naftë D1 (kodi doganor 27101943), naftë D2 (kodi doganor 27101946 dhe 29101948), benzinë pa plumb (kodi doganor 27101245, 27101241), solar/mazut (kodi doganor 27101962, 27101964, 27101968), naftë bruto (kodi doganor 27090090), për të cilat është e detyrueshme pagesa e akcizës apo e rentës minerare në rastin e naftës bruto.

1.10 “Subjektet e detyruara”, të gjitha subjektet që tregtojnë, eksportojnë, importojnë, shpërndajnë, transportojnë, magazinonë, prodhojnë, rafinojnë ose kryejnë çdo aktivitetet tjetër tregtar me produktet e shënjimit, që janë të detyruara të paguajnë detyrimet fiskale për produktet e shënjimit dhe të kërkojnë kryerjen e shërbimit të shënjimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës të zotëruar prej tyre, sipas kuadrit ligjor në fuqi për shërbimin e shënjimit dhe sipas këtij vendimi.

1.11 “Shërbimi i shënjimit”, procesi i shënjimit dhe monitorimit të produkteve të shënjimit, i cili përbëhet nga dy fazat si më poshtë vijon:

i) “Shërbimi i shënjimit”, që do të thotë procesi me anë të të cilit në produktet e shënjimit injektohet nga koncesionari shënjuesi; dhe

ii) “Shërbimi i monitorimit”, që do të thotë procesi me anë të të cilit koncesionari monitoron me anë të teknologjisë së posaçme në dispozicion të tij nëse produktet e shënjimit i janë nënshtuar shërbimit të shënjimit.

## 2. Fusha e zbatimit dhe ndalimet

2.1 Në përputhje me këtë vendim, subjektet e detyruara pajisen me shërbimin e shënjimit për të gjitha produktet e shënjimit të zotëruara prej tyre.

2.2. Shënjuesi do të injektohet në brendësi të produkteve të shënjimit, nga personeli i autorizuar i koncesionarit, me anë të teknologjisë së vendosur në dispozicion nga koncesionari.

## 2.3 Ndalohet:

2.3.1 Tregtimi, eksportimi, importimi, shpërndarja, transportimi, magazinimi, prodhimi, rafinimi ose kryerja e çdo aktiviteti tjetër tregtar me produktet e shënjimit që nuk përmbajnë shënjuesin e injektuar nga koncesionari sipas procedurave të hollësishme të përcaktuara në këtë vendim.

2.3.2 Importimi, prodhimi, mbajtja, shitja ose disponimi në çfarëdo mënyre i substancave të ngjashme me shënjuesin, ose që pretendohen të ngjashme me shënjuesin, nga subjekte të ndryshme nga koncesionari apo personeli i autorizuar i koncesionarit, me përjashtim të subjekteve rregullisht të kontraktuara nga koncesionari dhe të autorizuar prej tij për këtë qëllim.

2.3.3 Kryerja e çdo ndërhyrjeje teknike në pajisjet dhe teknologjinë e vënë në dispozicion nga koncesionari për kryerjen e shërbimit të shënjimit.

2.3.4 Kryerja e çdo veprimi që ka për qëllim të pengojë shërbimin e shënjimit.

## 3. Porositja dhe pagesa e shërbimit të shënjimit

3.1 Subjektet e detyruara duhet të porosisin dhe të paguajnë shërbimin e shënjimit pranë pikave të posaçme të ngritura nga koncesionari për këtë qëllim. Shërbimi i shënjimit do të kërkohej nga

subjektet e detyruara dhe do të realizohet nga koncesionari përpara kryerjes së pagesës së detyrimeve fiskale për produktet e shënjimit në zotërim të subjekteve të detyruara. Autoritetet doganore apo tatimore, sipas rastit, nuk do të pranojnë shlyerjen e detyrimeve fiskale nga subjektet e detyruara sipas këtij vendimi, përpara se këta të fundit të kenë kryer shërbimin e shënjimit mbi produktet e tyre. Përkatësisht:

i) Për sa i përket produkteve të shënjimit për të cilat është e detyrueshme pagesa e akcizës, shënjimi bëhet në momentin kur lind detyrimi për pagesën e akcizës. Asnjë nga produktet e shënjimit për të cilat është e detyrueshme pagesa e akcizës, nuk mund të qarkullojë i pashënuar sipas përcaktimeve të parashikuara në këtë vendim. Administrata doganore, në përputhje me parashikimet e nenit 39 të ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i lëshon subjektit një dokument shoqërues administrativ (DSHA) për akcizën e paguar. DSHA-ja do të lëshohet nga administrata doganore, vetëm pasi subjekti i detyruar të paraqesë konfirmimin e shënjimit të sasisë përkatëse të produktit të shënjimit. Ky konfirmim gjenerohet nga koncesionari.

ii) Për sa i përket naftës bruto, produkt për të cilin paguhet renta minerare, në momentin kur nafta bruto del nga depozitat/terminalët e prodhuesve të nëntokës lind detyrimi i regjistrimit të sasisë së dalë në sistemin e doganave apo atë tatimor, dhe rrjedhimisht detyrimi i shoqërimit të naftës bruto me DSHA-në e shoqërimit të mallit në lëvizje. Shënjimi i naftës bruto do të bëhet përpara regjistrimit të sasisë së naftës bruto në sistemin e doganave dhe lëshimit të DSHA-së së shoqërimit të mallit në lëvizje. Administrata doganore do ta pajisë subjektin e detyruar me këtë DSHA, vetëm pasi subjekti i detyruar të paraqesë konfirmimin e shënjimit të sasisë përkatëse. Ky konfirmim gjenerohet nga koncesionari.

Dokumenti që vërteton kryerjen e shërbimit të shënjimit i gjeneruar nga koncesionari, do të jetë një nga dokumentet e domosdoshme për të vendosur produktet e shënuara për qarkullim të lirë.

3.2. Subjektet e detyruara duhet të porosisin pranë koncesionarit dhe të mundësojnë realizimin e shërbimit të shënjimit mbi produktet e shënjimit të zotëruara prej tyre, në përputhje me afatet e parashikuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3.3 Çdo porosi duhet të specifikojë:

- i) identitetin e subjektit që kërkon kryerjen e shërbimit të shënjimit;
- ii) veprimtarinë tregtare të zhvilluar nga subjekti zotërues i produktit të shënjimit;
- iii) llojin e produktit;
- iv) vëllimin e produktit duke përcaktuar nëse ky i fundit është prodhim vendi apo i importit;
- v) vendndodhjen e produktit dhe mënyrën e ruajtjes së tij.

3.4 Koncesionari do të regjistrojë porosinë e marra në regjistrin e posaçëm të porosive. Pas marrjes së porosive dhe derdhjes së pagesës, koncesionari do të kryejë shërbimin e shënjimit “sa më parë të jetë e mundur”, por jo më vonë se 2 ditë pune pas datës në të cilën koncesionari ka marrë porosinë. Shërbimi i shënjimit do të kryhet nga personeli i autorizuar i koncesionarit, në vendin e depozitimit të produktit të shënjimit, siç specifikohet në porosinë e bërë nga secili subjekt i detyruar.

3.5. Subjektet e detyruara, të cilat porosisin pranë koncesionarit shërbimin e shënjimit pas pagesës së çmimit të shërbimit të shënjimit do të tërheqin vërtetimin përkatës.

4. Zbatimi i shërbimit të shënjimit

4.1 Parimet kryesore të zbatueshme në shërbimin e shënjimit janë si më poshtë vijon:

a) Asnjë nga produktet e shënjimit nuk do të tregtohet në tregun e Republikës së Shqipërisë apo eksportohet jashtë tij, nëse nuk i është nënshtruar më parë shërbimit të shënjimit të ofruar nga koncesionari.

b) Çmimi i shërbimit të shënjimit do të paguhet nga subjektet e detyruara te koncesionari.

c) Koncesionari ka të drejtën ekskluzive të ofrojë shërbimin e shënjimit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për të gjitha produktet e shënjimit, dhe të mbledhë çmimin e shërbimit të shënjimit përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit.

ç) Koncesionari ka të drejtën të hyjë dhe të ketë akses në të gjitha vendndodhjet e produkteve të shënjimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar, pikat e naftës bruto ose të karburanteve, me qëllim kryerjen e shërbimit të shënjimit.



4.2 Koncesionari do t'u paraqesë subjekteve të detyruara, për pjesën ku prekin aktivitetin e zhvilluar prej tyre, direktivat e zbatimit të shërbimit të shënjimit, siç janë përcaktuar në projektin e zbatimit të shërbimit të shënjimit, të hartuar nga koncesionari dhe të miratuar nga autoriteti kontraktues në përputhje me kontratën e koncesionit. Zbatimi i shërbimit të shënjimit është i ndarë në aktivitetet e mëposhtme:

a) Injektimi i shënjuesit në të gjitha produktet e shënjimit të tregtuara në tregun vendas apo për eksport me metodologjinë automatike apo manuale.

b) Verifikimi me anë të monitorimit të shënjimit në produktet e shënjimit të disponuara nga subjektet e detyruara, me anë të teknologjisë së monitorimit në dispozicion të koncesionarit.

c) Vënia në dispozicion nga ana e koncesionarit të raporteve të menaxhimit dhe të të dhënave në lidhje me zbatimin e shërbimit të shënjimit sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në kontratën e koncesionit.

#### 4.3. Shërbimi i monitorimit

4.3.1 Shërbimi i monitorimit do të kryhet nga koncesionari dhe do të konsistojë përkatësisht në monitorimin me anë të teknologjisë të posaçme në dispozicion të tij, të kryerjes të shërbimit të shënjimit.

4.3.2 Për realizimin e shërbimit të monitorimit, koncesionari do të përdorë teknologjinë e vënë në dispozicion prej tij, që konsiston në analizatorë/detektorë portativë, në formën e laboratorëve lëvizës të analizave.

4.3.3 Përfaqësuesit e autoritetit do të shoqërojnë koncesionarin në të gjitha aktivitetet e monitorimit të kryera prej tij në Republikën e Shqipërisë dhe do t'i garantojnë koncesionarit akses të plotë në të gjitha pikat ku gjenden produktet e shënjimit të cilat do t'i nënshtrohen kontrollit. Për këtë qëllim autoriteti do të vendosë 5 persona përgjegjës që do të shoqërojnë koncesionarin gjatë shërbimit të monitorimit.

4.3.4 Koncesionari do të hartojë programin e monitorimeve, i cili do të mbahet rreptësisht konfidencial. Objektet e monitorimit, koha dhe pikat, të cilat do të monitorohen do të përcaktohen vetëm nga koncesionari dhe nuk do t'i njoftohen më parë autoritetit, përveç rasteve kur monitorimi kërkohet nga autoriteti, i cili ka të drejtë të kërkojë kryerjen e monitorimit brenda numrit maksimal të monitorimeve të parashikuara në kontratën e koncesionit dhe jo më shumë se 20 monitorime në muaj. Ditën e monitorimit, koncesionari do t'i kërkojë autoritetit të vendosë në dispozicion të tij, përfaqësuesit e autoritetit, të cilët do të shoqërojnë ekipin e koncesionarit në aktivitetin e monitorimit, pa i vënë më parë në dijeni për pikat konkrete dhe kohën e monitorimit. Në rastet kur monitorimi kërkohet nga autoriteti, ky i fundit njofton koncesionarin, i cili përcakton kohën, që të jetë "sa më shpejt e mundur", por jo më shumë se 3 ditë nga marrja e njoftimit.

4.3.5 Shërbimi i monitorimit i përshkruar në nënpikën 4.3.4 do të kryhet nga koncesionari pa kufizime kohe, vendndodhje apo subjekti, dhe pa detyrim të njoftimit paraprak jo vetëm të autoritetit, por edhe të subjekteve të detyruara. Ruajtja e konfidencialitetit të shërbimit të monitorimit, është parimi themelor i zbatueshëm për realizimin e suksesshëm të tij.

#### 5. Detyrimet e koncesionarit dhe subjekteve të detyruara

5.1 Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe para fillimit të zbatimit të shërbimit të shënjimit, subjektet e detyruara do të krijojnë akses të plotë në të gjitha strukturat dhe ambientet e tyre për koncesionarin, me qëllim që t'i mundësojnë këtij të fundit dizenjimin e plotë dhe ngritjen e projektit të shërbimit të shënjimit.

5.2 Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi dhe në përputhje me afatet e përcaktuara në aneksin 1 bashkëlidhur këtij vendimi subjektet e detyruara duhet të sigurohen që asnjë nga produktet e shënjimit të zotëruara prej tyre, të mos qarkullojnë në tregun e Republikës së Shqipërisë para se t'i nënshtrohen shërbimit të shënjimit nga koncesionari.

5.3 Subjektet e detyruara duhet t'i lejojnë personelit të autorizuar të koncesionarit hyrjen në ambientet e tyre dhe në të gjitha pikat ku ndodhen produktet e shënjimit dhe t'i krijojnë të gjitha kushtet e lehtësirat e mundshme me qëllim realizimin e shërbimit të shënjimit.

5.4 Subjektet e detyruara duhet të plotësojnë kërkesat teknike të koncesionarit, për t'i mundësuar realizimin e shërbimit të shënjimit. Specifikisht, shërbimi i shënjimit të naftës bruto, mund të realizohet vetëm kur nafta bruto është në gjendje të lëngshme. Për realizimin e shërbimit të shënjimit të naftës bruto, është e domosdoshme që kjo e fundit të ndodhet në gjendje të lëngshme. Për këtë arsye, subjektet e detyruara, që disponojnë naftën bruto, kanë detyrimin të përgatisin naftën bruto për shërbimin e shënjimit, duke e kthyer atë në gjendje të lëngshme me anë të praktikave të njohura të zbatueshme në industrinë e naftës. Mospërbushja nga subjektet e detyruara të kërkesave teknike që bëjnë të mundur realizimin e shërbimit të shënjimit dhe veçanërisht refuzimi për të mbajtur naftën bruto në formë të lëngshme për kryerjen e shërbimit të shënjimit, do të konsiderohen pengesë e qëllimshme e realizimit të shërbimit të shënjimit nga ana e subjekteve të detyruara.

5.5 Koncesionari duhet t'ua paraqesë direktivat e zbatimit të gjitha subjekteve të detyruara të cilat duhet të bashkëpunojnë me koncesionarin për instalimin e pajisjeve të nevojshme për shënjimin e produkteve të shënjimit, nëse kjo konsiderohet e domosdoshme. Këto direktiva të zbatimit do të përgatiten pas kryerjes së inspektimeve teknike nga ana e koncesionarit të pikave në terren ku zhvillojnë aktivitetin e tyre subjektet e detyruara, me mbështetjen e autoritetit dhe do t'i paraqiten këtij të fundit për miratim si pjesë e projektit të zbatimit të shërbimit të shënjimit, në përputhje me parashikimet e kontratës së koncesionit. Autoriteti njeh dhe miraton projektin dhe direktivat e zbatimit të parashikuara në projekt dhe bën të mundur komunikimin e menjëhershëm të tyre ndaj subjekteve të detyruara, për fillimin e zbatimit të tyre në një afat optimal. Këto direktiva do të mbulojnë, në mënyrë të veçantë:

- i) specifikimin e llojit të pajisjes që do të instalohet nga koncesionari dhe periudhën e përafërt gjatë së cilës sistemi do të instalohet;
- ii) përshtatjet që duhet të bëhen nga subjektet e detyruara për instalimin e secilës pajisje të sistemit;
- iii) bashkëpunimin e nevojshëm të subjekteve të detyruara kundrejt koncesionarit për instalimin e pajisjeve.

5.6 Pas marrjes së direktivave të zbatimit, subjektet e detyruara do të fillojnë zbatimin e menjëhershëm të tyre. Kjo procedurë përfshin sigurimin e aksesit për instalimin duke i dhënë të drejtë hyrjeje personelit të autorizuar, autorizimin e instalimeve të nevojshme dhe përshtatjet teknike të kërkuara nga koncesionari me qëllim realizimin e instalimit. Përgjegjësia për zbatimin dhe realizimin e përshtatjeve të nevojshme që kërkohen për instalimin e sistemit është e subjekteve të detyruara. Përgjegjësia për instalimin dhe kostot e instalimit të pajisjeve është e koncesionarit, i cili do të vijojë me instalimin e sistemit dhe me mirëmbajtjen e tij. Personeli i autorizuar i koncesionarit do të jetë vazhdimisht prezent në të gjitha терминаlet dhe pajisjet që do të instalohen sipas nënpikës 5.5.

5.7 Pengesat dhe moslejimi i ushtruar nga subjektet e detyruara në përbushjen e detyrimeve që vijnë si rrjedhojë e direktivave të zbatimit të përshkruara më sipër, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga autoriteti sipas nenit 93 të ligjit nr. 61/2012 "Për akcizat".

5.8 Pas përfundimit të instalimit të sistemit, koncesionari, në praninë e autoritetit dhe përfaqësuesve të subjektit të interesuar, duhet të përgatisë një inventar të pajisjeve të instaluara pranë subjektit të interesuar. Inventari do të nënshkruhet nga përfaqësues të të tria palëve dhe secila prej tyre do të mbajë në dorëzim një kopje të saj. Vetëm personeli i autorizuar i koncesionarit është kompetent për mirëmbajtjen, riparimin apo modifikimin e sistemit të instaluar pranë subjekteve të detyruara. Për këtë qëllim, subjekti i detyruar duhet t'i japë aksesin e nevojshëm personelit të autorizuar për të kryer të gjitha veprimet e mirëmbajtjes në çdo kohë dhe në vendet e caktuara.

#### 6. Ndhima e institucioneve të tjera

Të gjitha institucionet publike të Republikës së Shqipërisë, si dhe Policia e Shtetit janë të detyruara të ndihmojnë, të japin akses në informacion dhe të bashkëpunojnë me koncesionarin dhe autoritetin sa herë që këta të fundit e kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e këtij vendimi.

#### 7. Fillimi i shënjimit

Produktet e shënjimit do të fillojnë të shënjohen sipas afateve të parashikuara në aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi. Asnjë produkt i shënjimit nuk mund të tregtohet, të eksportohet, importohet,



shpërndahet, transportohet, magazinohet, prodhohet, rafinohet apo të jetë objekt i operacioneve të çfarëdollojshme tregtare në territorin e Shqipërisë, në rast se nuk i është nënshtruar shërbimit të shënjimit dhe monitorimit brenda afateve të parashikuara në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

#### 8. Dispozita kalimtare

Kushti i parashikuar nga neni 4.2 nënndarja “iv” e kontratës së koncesionit, miratuar me vendimin nr. 200, datë 13.3.2013 të Këshillit të Ministrave, sipas të cilit miratohet dhe hyn në fuqi udhëzimi i Ministrit të Financave për zbatimin e kontratës së koncesionit, konsiderohet i përmbushur me miratimin dhe hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**Aneksi:1**

Koncesionari do të zbatojë dhe realizojë aktivitetet e mëposhtme në vendodhjet e mëposhtme në Shqipëri:

Aktiviteti	Vendndodhja	Fillimi i aktivitetit, [*të jetë të paktën 30 ditë përpara markimit]	Fillimi i markimit
1. Mazut and Solar markim manual	Rafineria FIER	Fillimi i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses & instalime	01.07.13
2. Terminal karburanti, markim manual	Terminali Taci I në Porto Romano	Fillimi i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses& instalime	01.07.13
3. Terminal karburanti, markim manual	Terminali i karburantit AIDA në Porto Romano	Fillimi i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses& instalime	01.07.13
4. Terminal karburanti, markim manual	Terminali i Karburantit Kaspetro në Porto Romano	Fillimi i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses& instalime	01.07.13
5. Njësitë lëvizëse të markimit, të vendosura nëpër makina Mobile marking units, by car	Doganat, kufiri	Fillimi i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses& instalime	01.07.13
6. Njësitë e inspektimit XRF	Identifikimi i vendodhjes së produkteve të naftës në Shqipëri	Fillimi i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses& instalime	01.08.13
7. Markimi automatik i naftës bruto	Terminali i ngarkimit i Bankers Petroleum në Fier	Fillimi i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses& instalime	01.10.13
8. Markimi manual i naftës bruto	Terminali i ngarkimit i Trans oil në Visoke	Fillimi i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses& instalime	01.10.13
9. Markimi manual i naftës bruto	Terminali i ngarkimit i Stream oil në Usojë	Fillimi i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses& instalime	01.10.13
10. Markimi manual i naftës bruto	Terminali i ngarkimit i Stream oil në Gorisht	Fillimi i përgatitjeve për marrjen e të gjitha miratimeve të nevojshme formale për akses& instalime	01.10.13



**UDHËZIM**  
**Nr. 8, datë 10.6.2013**

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 30.4.2012 TË MINISTRIT TË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS “PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË APLIKIMEVE PËR MARRJEN E LEJEVE NDËRTIMORE PËR OBJEKTE TË NATYRËS ENERGJETIKE DHE OBJEKTE ME RREZIKSHMËRI TË LARTË TË KËSAJ FUSHE, SI DHE PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR DHËNIEN E KËTYRE LEJEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1/b1 të nenit 72, pikës 2 të nenit 76, nenit 78 dhe nenit 79 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, si dhe të pikës 1/b të nenit 12 dhe pikës 2 të nenit 18 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.7.2011 “Për miratimin e rregullores uniforme të kontrollit të zhvillimit të territorit”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Pika 6 e udhëzimit nr. 1, datë 30.4.2012, ndryshohet si vijon:

Vlerësimi i METE-s për dhënien e lejes për punime ndërtimore të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë të kësaj fushe (sipas llojit të lejes/lejeve, sikurse është kërkuar nga subjekti aplikues), i përgatitur nga ana e njësisë së METE-s që ka trajtuar aplikimin e subjektit për marrje leje për punime, si dhe dokumenti i planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e instrumentit të planifikimit), janë pjesë e dosjes që bashkëshoqëron praktikën që dorëzohet në komision, duke vënë në dijeni kryetarin e komisionit.

2. Pika 8/b e udhëzimit nr. 1, datë 30.4.2012, ndryshohet si vijon:

b) Mbi bazën e vlerësimit nga anëtarët e komisionit, si dhe duke pasur në konsideratë vlerësimin nga AKPT-ja, po ashtu edhe mendimin oponent nga institucione ose ekspertë të fushës, komisioni merr vendimin për:

i) pranim të kërkesës dhe aplikimit përkatës dhe për paraqitjen për miratim të ministri të vlerësimit që do të japë METE lidhur me dhënien e lejes për punime ndërtimi, sipas llojit të lejes/lejeve, sikurse është kërkuar nga subjekti aplikues, si dhe të dokumentit të planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e instrumentit të planifikimit) të firmosur paraprakisht nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka nën juridiksion zonën e vendndodhjes së strukturës që do të ndërtohet.

Kërkesa dhe aplikimi përkatës shoqëruar me vlerësimin e METE-s lidhur me dhënien e lejes për punime ndërtimi, sipas llojit të lejes/lejeve përcillen në AKPT për procedim të mëtejshëm për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT);

ii) refuzim të kërkesës dhe aplikimit përkatës, duke paraqitur të ministri informacionin me argumentet përkatëse për shkaqet e refuzimit të dhënies së lejes për punime ndërtimi.

Komisioni merr vendim me shumicë votash.

3. Pika 11 e udhëzimit nr. 1, datë 30.4.2012, ndryshohet si vijon:

Në rast refuzimi të kërkesës dhe aplikimit përkatës për procedim të mëtejshëm për marrje leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektiv të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, njoftohet subjekti aplikues duke dhënë edhe argumentet përkatëse për shkaqet e refuzimit sipas kërkesës së paraqitur.

4. Pika 12 e udhëzimit nr. 1, datë 30.4.2012, ndryshohet si vijon:

Subjekti ka të drejtë që brenda një afati 30-ditor të bëjë plotësim të mangësive të vërejtura nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, si dhe/ose të paraqesë materiale plotësuese dhe sqaruese për aplikimin e paraqitur.

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënie leje për ndërtim dhe shfrytëzim objektsh të natyrës energjetike dhe objekte me rrezikshmëri të lartë në këtë fushë, mbi bazën e një raporti plotësues të përgatitur nga njësia e METE-s, që mbulon fushën e aktivitetit energjetik përkatës për objektet për të cilat është paraqitur kërkesa dhe aplikimi përkatës për marrje leje për punime ndërtimore, brenda një periudhe 15-ditore rishqyrton aplikimin e paraqitur dhe merr vendimin përkatës.

Në rast pranimit të kërkesës dhe aplikimit të riparaqitur nga subjekti i interesuar, komisioni, në përputhje me procedurën e përshtuar në pikën 8 më sipër, paraqet te ministri për miratim dokumentacionin përkatës të vlerësimit të METE-s për dhënien e lejes për punime ndërtimi, sipas llojit të lejes/lejeve, sikurse është kërkuar nga subjekti aplikues.

Në rast refuzimi për herë të dytë të procedimit për dhënien e lejes për punime ndërtimi, sipas kërkesës së paraqitur, subjekti ka të drejtë të paraqesë kërkesë ankimore në organet gjyqësore.

5. Pika 13 e udhëzimit nr. 1, datë 30.4.2012, ndryshohet si vijon:

Njësia përkatëse që ka trajtuar aplikimin e subjektit për marrje lejeje për punime ndërtimore, përgatit praktikën për dërgim në AKPT:

a) një kopje të vlerësimit të METE-s për procedimin e mëtejshëm për shqyrtim dhe miratim në KKT të aplikimit për dhënien e lejes për punime ndërtimi të firmosur nga ministri; si dhe

b) një kopje të firmosur nga ministri të dokumentit të planit të vendosjes së ndërtimit, që përmban planin e vendosjes së strukturës ndërtimore, lidhjen e strukturës me infrastrukturën në zonë, si dhe pozicionin e saj në kuadër të planit të miratuar (në rast se ekzistenca e këtij plani është kërkesë e instrumentit të planifikimit), të firmosur nga ministri dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore që ka nën juridiksion zonën e vendndodhjes së strukturës që do të ndërtohet.

6. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen njësitë e METE-s, që mbulojnë aktivitetin energjetik përkatës, si dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, shpallet në faqen zyrtare web të METE-s dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS  
**Florjon Mima**

## URDHËR

Nr. 88, datë 14.6.2013

### **PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR AUTORIZIMET ME KREDENCIALE TË INSPEKTORËVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, si dhe në përputhje me ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar,

## URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për autorizimet me kredenciale të inspektorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil të marrë masat për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
**Sokol Olldashi**



## **RREGULLORE** **PËR AUTORIZIMET ME KREDENCIALE TË INSPEKTORËVE TË AUTORITETIT TË** **AVIACIONIT CIVIL**

### Neni 1

#### **Fusha e veprimit**

1.1 Kjo rregullore përcakton rregullat e përgjithshme, mbi bazën e të cilave inspektorët e Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë, pajisen me autorizimet përkatëse sipas fushave respektive, për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore të autorizuara.

1.2 Kjo rregullore, gjithashtu, përcakton formën dhe përmbajtjen e kartelës së kredencialeve të inspektorit të aviacionit.

### Neni 2

#### **Përkufizimet**

Për qëllim të kësaj rregulloreje, përkufizimet që përdoren këtu, kanë kuptimet në vijim:

“Inspektor i aviacionit” nënkupton një nëpunës të AAC-së, të cilit i është akorduar ky titull pas plotësimit të disa kushteve të nevojshme, të cilat do të përcaktohen në një procedurë të brendshme të AAC-së dhe/ose manualin përkatës dhe në përputhje me procedurat e përshkruara në manualin e cilësisë, nëpunës, të cilit i jepet e drejta të kryejë detyra të veçanta mbikëqyrjeje të përcaktuara në ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar.

“Kredenciale” nënkupton të drejta dhe detyrime të caktuara, mbi bazën dhe llojin e kualifikimit të veçantë që lidhet me kompetencat e AAC-së, në përputhje me ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, të cilat formalizohen nëpërmjet dhënies së një kartele plastike e të printuar mirë, me informacione personale të inspektorit të AAC-së, të caktuara në këtë rregullore dhe shtojcën e saj.

“Trajnim në punë (TNP)” nënkupton fitimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave si rezultat i mësimin të shkathtësive profesionale dhe praktike, dhe njohurive që lidhen me kompetenca të veçanta mbikëqyrëse.

“AAC” nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar.

“Komisioni i ankesave” nënkupton komisionin që do të krijohet me urdhër të Ministrit, me propozim të drejtorit ekzekutiv të AAC-së.

### Neni 3

#### **Identifikimi i inspektorëve të aviacionit të AAC-së**

3.1 Kartela e kredencialeve të inspektorit do të identifikojë mbajtësin e saj si një përfaqësues të akredituar të AAC-së, të autorizuar për të ushtruar funksione e detyra të veçanta mbikëqyrëse, në kuadër të përgjegjësive të përcaktuara në ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjin nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, si edhe në këtë rregullore.

3.2 Inspektorët e aviacionit duhet ta ekspozojnë kartelën e kredencialeve dhe të prezantohen para se të ndërmarrin çfarëdo detyra të përshkruar në nenin 4.

#### Neni 4

#### **Autorizimet e inspektorëve të AAC-së**

Në kuadër të detyrave dhe përgjegjësiwe ligjore të përshkruara më lart në nenin 3.1, të shprehura edhe në kartelën e kredencialewe, inspektorët e AAC-së, mbajtës të kredencialewe, janë të autorizuar:

a) të kërkojnë dhe t'u lejohet akses në secilin mjet ajror, strukturë të mjetit ajror, pajisjet dhe veglat e tij, si dhe dokumentacionin, duke përfshirë certifikatat dhe manualët e secilit anëtar të audituar apo të inspektuar të ekuipazhit të fluturimit të një operatori të huaj apo vendas;

b) të kryejnë inspektime gjatë fluturimit dhe kontrollit të linjave, të kryejnë inspektime gjatë fluturimit të një mjeti ajror të ri dhe linjave të reja të një operatori.

c) të kërkojnë dhe t'u lejohet qasje e papenguar te Ofruesit e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (OSHNA), strukturat e tyre, pajisjet e mjetet, si dhe dokumentet, duke përfshirë certifikatat, manualët, regjistrat dhe të dhënat e çdo zyrtari të OSHNA-së;

d) të kërkojnë dhe t'u lejohet akses në aerodrome, strukturat e tyre, pajisjet e mjetet, si dhe dokumentet, duke përfshirë certifikatat, manualët, regjistrat dhe të dhënat e çdo zyrtari të aerodromit;

e) të mbikëqyrin dhe të vëzhgojnë implementimin e dispozitave përkatëse të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 "Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 10 233, datë 11.2.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", të ndryshuar, dhe/apo akteve nënligjore që burojnë prej tyre;

f) të marrin në pyetje të gjithë personat, përgjigjet e të cilëve vlerësohen si të nevojshme për zhvillimin e një procedure inspektimi, kontrolli apo auditimi;

g) të kontrollojnë dokumentet e identifikimit të secilit person, i cili i nënshtrohet inspektimit, auditimit apo hetimit;

h) të përpilojnë raporte për auditime/inspektime, të cilat zhvillohen sipas pikave "a", "b", "c", "d", "e", "f" dhe "g" të këtij neni;

i) të kërkojnë asistencën e zyrtarëve/autoriteteve të tjera publike dhe strukturave të policisë, nëse ndeshen me ndonjë sulm apo refuzim për t'i trajtuar me respekt, apo nëse një ballafaqim i tillë është i pritshëm në mënyrë të arsyeshme nga ndonjë person gjatë kryerjes së autorizimeve të dhëna nën pikat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g" dhe "h" të këtij neni;

j) të marrin masa të ndalojnë ushtrimin e privilegjeve që ka një subjekt, mbajtës i një licence apo certifikate, kur konstatohet që ushtrimi i mëtejshëm i privilegjeve cenon rëndë sigurinë (*safety* dhe *security*).

#### Neni 5

#### **Autoriteti miratues**

1. Drejtori ekzekutiv i AAC-së është autoriteti miratues për dhënien e kredencialewe.

2. Drejtori ekzekutiv i AAC-së, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësiwe të ngarkuara nga ligji nr. 10 233, datë 11.2.2010 "Për Autoritetin Aviacionit Civil", të ndryshuar, neni 13, veçanërisht pikat "a" dhe "ë" të tij, si dhe neni 23 i tij, mund të autorizojë inspektorët e AAC-së, me anë të kredencialewe, të kryejnë inspektime dhe të marrin masa ndaj të tretëve në funksion të ruajtjes së standardeve të sigurisë në aviacion, të përcaktuara në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

3. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, Autoriteti i Aviacionit Civil do të hartojë procedurën, e cila do të përcaktojë:

- kushtet dhe kriteret bazë për pajisjen me kredenciale;
- kualifikimet specifike të dokumentuara dhe të certifikuara;
- kategorizimet e inspektorëve në varësi të kompetencave të dhëna me anë të kredencialewe;
- procesin e detajuar të dhënies së kredencialewe.

4. Drejtorja e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë do të administrojë procesin e lëshimit dhe kontrollit të kredencialewe të lëshuara.



## Neni 6

### **Pamja e kartelës së kredencialeve të inspektorit**

6.1 Kartela e kredencialeve e printuar është një kartelë e hollë e lehtë plastike dhe përdoret për identifikimin dhe autorizimet e inspektorit të AAC-së gjatë ushtrimit të detyrave të mbikëqyrjes.

6.2 Kjo kartelë ka dy anë të vlefshme me dimensione 85 mm x 55mm, me stemën e Republikës së Shqipërisë dhe emblemën e AAC-së, fotografinë e mbajtësit me dimensione 3mm x 27mm, numrin serial, datën e lëshimit dhe atë të mbarimit të afatit, titullin dhe emrin e mbajtësit në anën e përparme dhe e cila përmban këtë deklaratë në gjuhën shqipe dhe angleze në anën e pasme:

“Me këtë vërtetohet se mbajtësi i këtyre kredencialeve është inspektor i autorizuar i AAC-së për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve në përputhje me ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në përputhje me nenin 13 dhe nenin 23 të ligjit nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi. Ai/ajo mundet pa ndonjë autorizim apo kufizim të posaçëm, të hyjë dhe të inspektojë çdo mjet civil ajror apo objekt (pajisje) të aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë dhe të inspektojë personelin e aviacionit.”.

6.3 Forma e kredencialeve është dhënë në shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

## Neni 7

### **Përdorimi i kredencialeve**

7.1 Kredencialet do të përdoren vetëm për ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive zyrtare, të përcaktuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 10 233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, të ndryshuar, dhe/apo aktet normative që burojnë prej tyre, të lëshuara nga AAC-ja. Mbajtësi i kredencialeve është përgjegjës për ruajtjen e kredencialeve. Keqpërdorimi apo posedimi i pavend i kredencialeve do t’u nënshtrohet masave disiplinore kundër shkelësit.

7.2 Inspektorët e AAC-së, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre të caktuara, dhe gjatë ndërveprimit me operatorë, personelin e operatorëve dhe publikun në përgjithësi, duhet të mbajnë gjykim të mirë dhe sjellje profesionale, të cilat reflektojnë politikat e praktikat e AAC-së, dhe gjithashtu duhet të përmbahen nga ndonjë veprim i pavend, i cili do të dëmtonte kredibilitetin e AAC-së si institucion publik i autorizuar me ligj për të kryer detyra dhe përgjegjësi rregullatore në fushën e aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 8

### **Raportimi i keqpërdorimit të autorizimit**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, Ministri me propozim të drejtorit ekzekutiv të AAC-së do të ngrejë Komisionin e Ankesave.

2. Secili person, që vlerëson se i është nënshtruar një trajtimi të papërshtatshëm nga një inspektor i AAC-së, apo i cili pretendon se ka pasur keqpërdorim të autorizimeve të inspektorit, duhet ta dorëzojë ankesën e tij/saj me shkrim, duke ia adresuar atë komisionit të ankesave në një zarf të mbyllur, brenda 15 ditëve pas ditës në të cilën ka ndodhur situata e pretenduar.

Shtojca 1

 Republika e Shqipërisë Republic of Albania	 Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar Civil Aviation Authority of Albania
<div style="border: 1px solid black; width: 100px; height: 100px; display: flex; align-items: center; justify-content: center;"> <p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg); font-size: 24px; font-weight: bold;">Foto</p> </div>	<p><b>KREDENCIALET E INSPEKTORIT</b> INSPECTOR CREDENTIALS</p> <p><i>Emri / Name:</i> <b>EMRI MBIEMRI</b></p> <p><i>Data e lëshimit / Issuing Date:</i> <b>dd.mm.vvvv</b></p> <p><i>Data e skadimit / Expiry Date:</i> <b>dd.mm.vvvv</b></p> <p>Serial No <b>CAA-XX/XXXX</b></p> <p><b>Psh. Inspektor per operimet</b></p>

*"Me këtë vërtetohet se mbajtësi i këtyre kredencialeve është inspektor i autorizuar i AAC-së për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve në përputhje me Ligjin Nr. 10040, date 22.12.2008 "Kodi Ajror i RSH-se", i ndryshuar dhe Nenin 13 dhe nenin 23 të Ligjit Nr 10233, date 11.02.2010 "Per Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar si dhe akteve tjera nënligjore në fuqi. Ai/Ajo mundet pa ndonjë autorizim apo kufizim të posaçëm, të hyjë dhe inspektojë çdo mjet civil ajror apo objekt(pajisje) të aviacionit civil në Republikën e Shqipërisë dhe të inspektojë personelin e aviacionit.*

*"This is to certify that the holder of these Credentials is a duly authorized inspector of CAA for undertaking all actions in accordance with Law Nr. 10040, date 22.12.2008 "Air Code of Albania", and its amendment and Article 13 and Article 23 of Law No 10233, date 11.02.2010 "For the Civil Aviation authority", and its amendment and the bylaws in force. He/she can enter and inspect any civilian aircraft or aviation facility in the Republic of Albania and inspect aviation personnel, without any special authorization or restrictions.*

**VENDIM**

**Nr. 26, datë 24.6.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i " "
Vitore Tusha	Anëtare e " "
Altina Xhoxhaj	Anëtare e " "
Fatmir Hoxha	Anëtar i " "
Gani Dizdari	Anëtar i " "
Besnik Imeraj	Anëtar i " "
Sokol Berberi	Anëtar i " "

me sekretare Blerina Basha, në datën 16.4.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 5 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Bledar Lasku, Kleanthi Kekezi, Rezarta Ngjelo

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2012-1554, datë 28.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.





BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

1. Kërkuesit janë trashëgimtarë të K.L., ish-pronar i një trualli prej 2025 m<sup>2</sup> në Tiranë. Me vendimet nr. 562, datë 20.5.1996, nr. 705, datë 30.9.1996 dhe nr. 170, datë 30.9.1997 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Tiranë, është vendosur kompensimi fizik i trashëgimtarëve duke i kompensuar me një sipërfaqe prej 1070 m<sup>2</sup>, duke qenë se trualli në pronësi të trashëgimlënësit ishte i zënë nga ish-uzina elektromekanike.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), me vendimin nr. 480, datë 27.11.2007 ka vendosur: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve nr. 562, datë 20.5.1996, nr. 705, datë 30.9.1996 dhe nr. 170, datë 30.9.1997 të KKKP-së Tiranë; kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura”. Kjo procedurë u bazua në nenet 16 dhe 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

3. Kërkuesit ngritën padi kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila, me vendimin nr. 7086, datë 25.7.2008, ka vendosur: “Pranimin e padisë; shfuqizimin tërësisht të vendimit nr. 480, datë 27.11.2007”.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 241, datë 15.2.2010 ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 7086, datë 25.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë”.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2012-1554, datë 28.6.2012, ka vendosur: “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesit”.

6. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar se ndaj tyre është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në Gjykatën e Lartë, gjatë shqyrtimit të rekursit, pasi:

6.1 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë në shqyrtim shkaqet e rekursit, të cilat ishin të tilla që duheshin shqyrtuar në seancë gjyqësore. Këto shkaqe nuk janë përmendur as formalisht në vendimin e Kolegjit;

6.2 Kompetenca e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së për të shfuqizuar vendimet e KKKP-së, tashmë në fuqi prej vitesh, është antikushtetuese, bazuar në vendimet nr. 27, datë 26.5.2010 dhe nr. 43, datë 6.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese. Këto vendime kanë shfuqizuar nenet e ligjit përkatës që parashikonin kompetencën e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së për të rishikuar vendimet e KKKP-së të formës së prerë;

6.3 Për marrjen e vendimeve, objekt kundërshtimi, AKKP-ja i është referuar Kodit të Procedurave Administrative, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 1999, ndërkohë që vendimet e KKKP-së janë marrë në vitet 1996 dhe 1997;

6.4 Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në procedurën e ndjekur, nuk ka respektuar as kriteret minimale të procesit të rregullt ligjor, pasi nuk janë njoftuar të gjithë bashkëpronarët për procedurën e nisur dhe as pretendimet me shkrim të kërkuesve nuk janë marrë në shqyrtim.

7. **Subjekti i interesuar**, AKKP-ja ka paraqitur me shkrim prapësimet si vijon:

7.1 Vendimi nr. 00-2012-1554, datë 28.6.2012 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është një vendim i drejtë dhe i bazuar në ligjin material dhe procedural. Kërkuesit nuk kanë paraqitur asnjë fakt për të vërtetuar se jemi në kushtet e shkeljeve të rënda të normave ligjore, materiale dhe procedurale, sipas nenit 472 e vijues të KPC-së;



7.2 Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi prapavepruese vetëm ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë. Kjo fuqi prapavepruese nuk gjen zbatim në rastin konkret pasi vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, i dhënë në datën 15.2.2010, kishte marrë formë të prerë në datën 26.5.2010 kur është shpallur vendimi nr. 27, datë 26.5.2010 i Gjykatës Kushtetuese.

## II

### Vlerësimi i Gjykatës

#### **A. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor**

8. Kërkuesit kanë parashtruar se në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë shkaqet e rekursit nuk janë paraqitur as formalisht dhe nuk janë marrë në shqyrtim, megjithëse ishin të tilla që duheshin shqyrtuar në seancë gjyqësore.

9. Gjykata rithekson se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011 dhe nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka nënvizuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 7, datë 9.3.2009 dhe nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Megjithatë, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Gjykata vë në dukje se ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsytimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).



13. Neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480).

14. Nga parashikimet e dispozitave të KPC-së të lartpërmendura, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë dhe të aksesit në gjykatë, brenda kuadrit të procesit të rregullt ligjor, përmbajtja e vendimit duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar.

15. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i mospranimit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban, në pjesën hyrëse të tij, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit është paraqitur rekurs nga kërkuesit, por nuk përmban shkaqet që këta kanë parashtruar në rekurs. Ndërsa në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij. Pra, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të apelit, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të tyre nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv.

16. Gjykata, nisur dhe nga sa u argumentua më lart dhe duke iu referuar jurisprudencës së saj, çmon gjithashtu se, *prima facie*, mosparaqitja, në vendimin e Kolegjit Civil, e shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs, krijon dyshime edhe mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv, si dhe të të drejtës për t'u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuesi. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 15, datë 19.4.2013 dhe nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga analiza në tërësi e vendimit, Gjykata vlerëson se, për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që arsyetimi të mos ketë një harmoni të brendshme. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës, duke krijuar dyshime, ndër të tjera, edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesve.

#### **B. Për pretendimet e tjera**

18. Duke iu referuar arsyetimit më sipër, (*par. 17*), dyshimit për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesve, Gjykata thekson se është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoke në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuesve nga ana e saj.

19. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, rikonfirmon qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 19 datë 2.4.2012 dhe nr. 4, datë 28.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimi i mospranimit të rekursit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
  - Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-1554, datë 28.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
  - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Besnik Imeraj

#### MENDIM PARALEL

Në çështjen me kërkues Bledar Lasku etj., ndonëse ndajmë të njëjtin mendim me vendimin e shumicës për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2012-1554, datë 28.6.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), nuk pajtohem me të lidhur me arsyet mbi të cilat e mbështet vendimin e saj.

1. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar e ka konsideruar pjesë përbërëse dhe të pandarë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42, 142/1 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

2. Gjykata është shprehur se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Siç pranon edhe shumica në vendimin e saj, funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar duke iu dhënë njëkohësisht mundësinë ta kundërshtojnë atë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse (në rastin në fjalë nga Gjykata Kushtetuese) dhe, që kjo të bëhet e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe arsyet që e kanë shtyrë për të bërë zgjedhjen ndërmjet disa mundësive. Para së gjithash, ai duhet t’i japë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve në proces, pavarësisht se në kuptimin kushtetues një përgjigje e detajuar nuk është në çdo rast e domosdoshme (*shih vendimet nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 8, datë 16.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Më tej, Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre duke qenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012, nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Shumica, ndonëse me të drejtë i referohet në vendim nenit 310/1 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, në vlerësimin e saj bën një shprehje formale jo vetëm të këtyre elementeve përbërëse të një vendimi gjyqësor, por njëkohësisht anashkalon, në mënyrë të njëanshme, jurisprudencën e kësaj Gjykate referuar më lart.

5. Konkretisht, shumica e mbështet arsyetimin e saj për shfuqizimin e vendimit në fjalë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vetëm në konstatimin e faktit se në pjesën hyrëse të tij nuk janë



pasqyruar shkaqet për të cilat rekursuesit kanë kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas shumicës, një mangësi e tillë krijon dyshime mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv dhe të së drejtës për t'u dëgjuar.

6. Megjithëse vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i mungon pjesa arsyetuese, pra vlerësimi i pretendimeve të kërkuësve, qoftë dhe në mënyrë të përmbledhur, dhe qëndrimi që mban ky Kolegj për secilin prej tyre, shumicës i "intereson" vetëm paraqitja formale (ndonëse e nevojshme) e këtyre pretendimeve në pjesën hyrëse të vendimit. Sipas saj (shumicës) pikërisht mospasqyrimi i tyre është i mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit.

7. Në vlerësimin tonë, një qëndrim i tillë, megjithëse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve nga kolegjet e Gjykatës së Lartë, është skematik dhe i padobishëm, pa u shoqëruar me vlerësimin e pjesës më të rëndësishme të vendimit gjyqësor, ajo që quhet pjesa përshkruese-arsyetuese e tij. Mbi të gjitha, ky qëndrim nuk u shërben aspak kërkuësve, të cilët pretendimet e tyre për proces të parregullt ligjor i lidhin me cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese. Këtu qëndron, në këndvështrimin tonë, karakteri formal i vendimmarrjes së shumicës e cila, ndonëse nga njëra anë kënaq pretendimin e kërkuësve për shfuqizimin e vendimit në fjalë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nga ana tjetër, dhe që është më e rëndësishme, nuk i jep përgjigje pretendimeve me natyrë ligjore dhe kushtetuese të tyre. Pyetja që shtrohet në këtë rast është: A e përmbush standardin e arsyetimit një vendim i pritshëm i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i plotësuar tashmë, në formë, me parashtrimin e pretendimeve të kërkuësve? Mendojmë se jo.

8. Kërkuësit kanë pretenduar, para Gjykatës së Lartë, se Gjykata e Apelit Tiranë ka zhvilluar ndaj tyre një proces të parregullt ligjor sepse, duke vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së ngritur prej tyre, nuk ka marrë në konsideratë vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese e cila, në momentin e shqyrtimit të çështjes, e kishte shpallur si antikushtetuese të drejtën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për të rishikuar vendimet e formës së prerë të ish-Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Sipas tyre, vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi prapavepruese për çështjet që janë në shqyrtim. Duke mos marrë përgjigje lidhur me këtë pretendim me natyrë kushtetuese, kërkuësit e konsiderojnë procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë si të parregullt përderisa edhe vendimi i Kolegjit është i paarsyetuar. Ky është shkaku kryesor përse ata kërkojnë shfuqizimin e vendimit në fjalë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të paarsyetuar, dhe deklarimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën. Atyre nuk u intereson forma e vendimit të Kolegjit, por përmbajtja e tij.

9. Gjithashtu, kërkuësit kanë pretenduar në kërkesën e tyre drejtuar kësaj Gjykate, se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke mos e kaluar çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore, u ka cenuar të drejtën e ankimit efektiv dhe të aksesit, në kuptim të neneve 42 dhe 43 të Kushtetutës, përderisa vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, duke ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila kishte pranuar padinë e ngritur prej tyre, ka vendosur rrëzimin e saj. Në kushtet e dy vendimeve diametralisht të kundërta lidhur me themelin e çështjes, sipas tyre, bëhej i domosdoshëm shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore.

10. Nga kjo pikëpamje mendojmë se, në situata të tilla, ndonëse nga kjo Gjykatë nuk mund t'u kërkohej Kolegjeve të Gjykatës së Lartë kalimi i çështjes në seancë gjyqësore, pasi kjo është pjesë e juridiksionit të tyre, ajo që mund të konstatohet pa hezitim është fakti që kërkuësve, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tyre, u është mohuar e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës dhe, në këtë kuptim, kërkesa e tyre është e bazuar dhe duhet pranuar. Këto janë arsytet që, sipas këndvështrimit tonë, e bëjnë të cenueshëm, në kuptimin kushtetues, vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili, si i tillë, nuk plotëson standardin e arsyetimit të vendimit.

11. Një riformulim i vendimit nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në linjën e kërkuar nga shumica e kësaj Gjykate, përveç formalizmit, nuk përmbush pritshmëritë e kërkuësve, të cilët në këto rrethana mund t'i drejtohen përsëri Gjykatës Kushtetuese lidhur me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e pretenduara dhe të mbetura pa përgjigje.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj

**VENDIM**  
**Nr. 27, datë 24.6.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 15.1.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 52/25 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Shoqëria “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a., përfaqësuar nga avokatët Thimjo Kondi dhe Abdyl Sarja, me akt përfaqësimi.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Shoqëria “REAL X” sh.p.k., përfaqësuar nga avokati Theodhori Sollaku, me autorizim.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr. 00-2012-1593 (269), datë 24.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 00-2012-1593 (269), datë 24.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 16/2, 42, 131/f, 132/1 dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27 e vijues dhe neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Altina Xhoxhaj; përfaqësuesin e kërkuarit që kërkoi pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Në datën 11.4.2007, shoqëria “REAL X” sh.p.k. ka lidhur me shoqërinë “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” sh.a. (në vijim shoqëria “SIGAL” sh.a.), kontratën e sigurimit të mallrave në transport, duke u lëshuar polica e sigurimit 10/0101/nr. Serie 001949. Objekt i kontratës së sigurimit ishte sigurimi i mallit Screw Steel, 3000 ton, që transportohej nga Kina (Tianjin Xingang) në Shqipëri (Durrës) me mjetin e transportit anijen M/V “MARIAS IV” me policë ngarkese XGOI.XGO3. Shuma e sigurimit sipas kësaj police, ishte në masën 1.300.000 USD me kushtet “Total Loss Only” dhe vlera e primit të sigurimit ishte caktuar në masën 5.040 USD. Sipas kësaj kontrate, në rast humbjeje ose dëmtimi, vlera e dëmit do t’i paguhej mbajtësit të policës së sigurimit nga kërkuari.

2. Në datën 30.6.2007, rreth orës 19:00, anija që transportonte mallin, është mbytur në ujërat e Indisë së bashku me ngarkesën e siguruar. Shoqëria “REAL X” sh.p.k. ka kërkuar nga ana e shoqërisë “SIGAL” sh.a. përmbushjen e detyrimit kontraktor, por kjo e fundit nuk ka pranuar të përmbushë detyrimin duke pretenduar se shoqëria “REAL X” sh.p.k. nuk ka paguar primin e sigurimit dhe në këto kushte kontrata e sigurimit nuk ka hyrë asnjëherë në fuqi.



3. Shoqëria “REAL X” sh.p.k. i është drejtuar gjykatës për përmbushjen gjyqësive të detyrimit kontraktor sipas kontratës së sigurimit.

4. Me vendimin nr. 8071, datë 29.10.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesë padisë së palës paditëse shoqëria “REAL X” sh.p.k., si të pambështetur në ligj e në prova.*”

5. Me vendimin nr. 1461, datë 21.6.2011, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 8071, datë 29.10.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*” Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë shoqëria “REAL X” sh.p.k.

6. Me vendimin nr. 00-2012-1593 (269), datë 24.5.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 8071, datë 29.10.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit nr. 1461, datë 21.6.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke detyruar palën e paditur, shoqërinë “SIGAL” sh.a. Tiranë, t’i paguajë paditësit, shoqërisë “REAL X” sh.p.k. Tiranë shumën prej 1.300.000 USD sipas kontratës së sigurimit datë 11.4.2007, si dhe kamatat ligjore deri në ekzekutimin e vendimit.*”

## II

7. **Kërkuesi, shoqëria “SIGAL” sh.a.**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe paraqet këto argumente në mbrojtje të pretendimit për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor:

7.1. Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka bazuar vendimin në fakte e rrethana që nuk rezultojnë nga provat e marra e të vlerësuara nga dy gjykatat e faktit, ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave, si dhe i ka keqinterpretuar e keqzbatuar dispozitat ligjore që lidhen me çështjen. Nëpërmjet rivlerësimit të provave të marra gjatë gjykimit në shkallën e parë dhe në gjykatën e apelit kjo gjykatë ka ndryshuar faktet dhe rrethanat e çështjes dhe ka arritur në përfundime të ndryshme nga ato në të cilat kanë arritur gjykatat e faktit.

7.2. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e paanësisë, barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, për arsye se ka marrë të mirëqena *a priori* rrethana dhe konkluzione që nuk kanë rezultuar prej gjykimit në gjykatat e faktit e që nuk janë pranuar prej tyre, dhe nuk i ka dhënë mundësi kërkuesit të argumentojë pretendimet e tij, që deduktohen prej provave.

7.3. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka deformuar kuptimin e zakonit si burim i së drejtës duke shkelur parimet e shtetit të së drejtës, ndarjes së pushteteve dhe sigurisë juridike, pasi bën një shtrembërim të hapur të kuptimit, qëllimit dhe përmbajtjes së dispozitave eksplicite të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e sigurimit, duke konsideruar “zakon” apo “praktikë tregtare” një të ashtuquajtur praktikë pune në marrëdhëniet kontraktuale dypalëshe mes kërkuesit dhe subjektit të interesuar.

7.4. Është cenuar e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në një masë të konsiderueshme, është jokoherent, kontradiktor, jologjik dhe i paplotë.

7.5. Në lidhje me kërkesën për pezullim kërkuesi argumenton se vendimi i kundërshtuar është vënë në ekzekutim nëpërmjet procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm dhe se kjo i shkakton atij një dëm të konsiderueshëm dhe të vështirë për t’u riparuar më vonë.

8. **Subjekti i interesuar, shoqëria “REAL X” sh.p.k.**, parashtron në argumentet e tij para Gjykatës Kushtetuese:

8.1. Në çështjen konkrete në shqyrtim rezulton, përtej çdo dyshimi, se mes palëve në gjykim ka *de facto* një kontratë sigurimi të mallrave ndaj rreziqeve të transportit, polica nr. 001949, e lëshuar nga shoqëria e sigurimeve “SIGAL” sh.a., fakt ky i pranuar si nga palët ashtu edhe nga gjykatat. Ndërmjet vendimeve gjyqësore nuk ka asnjë kundërshti edhe për sa i përket objektit të kontratës së sigurimit, vlerës së primit të sigurimit dhe faktit se ka ndodhur ngjarja e sigurimit. Aty ku dallojnë si palët, ashtu edhe gjykatat, është lidhur me atë nëse ka hyrë ndonjëherë në fuqi kontrata e sigurimit dhe, rrjedhimisht, nëse ka sjellë pasoja për palët.

8.2. Konkluzioni i ndryshëm në të cilin arriti Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka ardhur si pasojë e interpretimit të ndryshëm të fakteve dhe rrethanave të çështjes, por ekskluzivisht si pasojë e

interpretimit të ndryshëm të ligjit, në përputhje me kompetencat e tij, duke vlerësuar, në përfundim, të gabuar e të pambështetur në ligj zgjidhjen e dhënë nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit.

8.3. Kërkuesi përmend në kërkesë koncepte të tilla si “gjykatë e pavarur dhe e paanshme” apo “barazi e armëve”, por të gjitha këto rrëzohen pasi Gjkata e Lartë nuk ka bërë rivlerësim të fakteve dhe rrethanave apo vlerësim provash të reja.

8.4 Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, referimi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në zakonin, si burim i së drejtës, nuk bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës, ndarjes së pushteteve dhe sigurisë juridike. Gjithsesi, kjo gjykatë i është referuar zakonit tregtar mes palëve, pa i kushtuar ndonjë rëndësi specifike dhe pësha e këtij referimi në arsyetimin e Gjykatës së Lartë është periferike, sikundër është e qartë se ndryshimi i vendimit të gjykatës së rrethit dhe të apelit ka ardhur për shkak të interpretimit të ndryshëm të dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhënien objekt shqyrtimi.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Gjkata Kushtetuese, paraprakisht, thekson se ajo i vlerëson pretendimet e kërkuetit në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, konkretisht, në aspektin e detyrimit të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për respektimin e këtyre standardeve.

*A. Lidhur me pretendimin për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 00-2012-1593 (269), datë 24.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*

10. Gjkata Kushtetuese (Gjkata), mori në shqyrtim, përpara seancës plenare, kërkesën për pezullimin e zbatimit të vendimit nr. 00-2012-1593 (269), datë 24.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me vendimin e datës 21.11.2012, Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk ndodhej para kushteve të parashikuara në këtë dispozitë.

11. Në seancë plenare, Gjkata u dha përsëri palëve mundësinë të paraqisnin argumente rreth kësaj kërkesë. Në përfundim të seancës plenare Gjkata, e tërhequr në dhomën e këshillimit, edhe për shkakun se u konstatua se ekzekutimi i vendimit të kundërshtuar është pezulluar tashmë, vendosi përsëri rrëzimin e kërkesës për mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 45 i ligjit organik të kësaj Gjykate.

*B. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit kushtetues të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj*

12. Kërkuesi pretendon se Gjkata e Lartë nuk ka respektuar standardin kushtetues të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj pasi ajo ka tejkuluar kompetencat dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes, duke e bazuar vendimin në fakte e rrethana që nuk rezultojnë nga provat e marra e të vlerësuara nga dy gjykatat e faktit, ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave, si dhe i ka keqinterpretuar e keqzbatuar dispozitat ligjore që lidhen me çështjen. Ai pretendon, gjithashtu, se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka marrë të mirëqena *a priori* rrethana dhe konkluzione që nuk kanë rezultuar prej gjykimit në gjykatat e faktit e që nuk janë pranuar prej tyre, si dhe se ka deformuar kuptimin e zakonit, si burim i së drejtës, duke shkelur parimet e shtetit të së drejtës, ndarjes së pushteteve dhe sigurisë juridike.

13. Gjkata ka theksuar se, bazuar në parimin *jura novit curia*, ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimet nr. 27, datë 9.5.2012; nr. 50, datë 9.5.2012; nr. 19, datë 25.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjkata vlerëson se pretendimet e mësipërme të kërkuetit, edhe pse ato janë paraqitur veçmas prej tij, duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

14. Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj, është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjkata ka theksuar se termi “*gjykatë*” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në një proces të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të





përcaktuar dhe në pajtim me shtetin e së drejtës. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente, kërkon që gjykata të ketë juridiksion për të dëgjuar çështjen dhe që kompetenca t'i jetë dhënë asaj prej ligjit (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 16, datë 27.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, i sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dy gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 31, datë 1.12.2005; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjyqtarit të faktit, por duhet të kthejë çështjen për rishqyrtim me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Bazuar në konsiderat e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se në gjykimin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë dhe atë të apelit, ka rezultuar e provuar se midis palëve në gjykim, shoqëria "SIGAL" sh.a. (siguruesi) dhe shoqëria "REAL X" sh.p.k. (i siguruari), është lidhur një kontratë sigurimi e mallrave në transport dhe, për këtë qëllim, është lëshuar polica e sigurimit e datës 11.4.2007. Po ashtu, ka rezultuar e provuar se siguruesi ka lëshuar faturën tatimore nr. serial 22949535, datë 12.4.2007, në vlerën 5.040 USD, që është vlera e primit të sigurimit, e cila është pranuar nga i siguruari, por pagesa e primit nuk është kryer prej tij. Për pasojë, gjykatat e faktit, në bazë të neneve 1113, 1124 dhe 1125 të Kodit Civil, duke vlerësuar se pagesa e primit është kushti me plotësimin e të cilit lind marrëdhënia e sigurimit dhe fillojnë efektet ligjore të kontratës së sigurimit, kanë vlerësuar se mospagimi i primit passjell edhe pushimin e kontratës duke e zhveshur siguruesin nga përmbushja e detyrimit. Po ashtu, pavarësisht se kontrata e sigurimit nuk ka prodhuar efekte, gjykatat e faktit kanë pranuar edhe se ka pasur shkelje të kushteve të sigurimit të përcaktuara në kontratë/policë, çka përsëri e çliron siguruesin nga detyrimi për dëmshpërblim.

18. Në ndryshim nga sa kanë arsyetuar gjykatat e faktit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se gjykatat kanë keqinterpretuar dispozitat e Kodit Civil, pasi përcaktimet e neneve 1124 dhe 1125 vlejné si rregullime të përgjithshme për kontratat e sigurimit të pasurisë, kurse në rastin konkret gjejné zbatim nenet 1147-1149, që rregullojnë kontratat e sigurimit të mallrave kundër rreziqeve gjatë transportit. Në kuptim të këtyre dispozitave hyrja në fuqi e kontratës lidhet me çastin e dorëzimit të mallit transportuesit, pra ajo ka hyrë në fuqi në datën kur malli (Screw Steel, 3000 ton) i



është dorëzuar transportuesit së bashku me dokumentacionin shoqërues dhe ka mbuluar sigurimin e këtij malli, jo për ndonjë periudhë kohe (afat) të përcaktuar, por deri në momentin kur ky mall do t'i dorëzohej pritësit, palës paditëse të këtij gjykimi (i siguruari). Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se kontrata e sigurimit, polica e sigurimit e datës 11.4.2007, ka qenë e vlefshme dhe se siguruari ka detyrimin t'i paguajë të siguruarit shpërblimin e sigurimit, brenda kufijve të shumës që është parashikuar në kontratë.

19. Gjykata vëren se gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se edhe pse i siguruari, shoqëria "REAL X" sh.p.k., ka pretenduar se ka paguar primin pas ndodhjes së ngjarjes, ky pretendim ka ngelur i paprovuar dhe se primi nuk është paguar asnjëherë, duke mos u plotësuar kështu detyrimi i vetëm i të siguruarit, i cili është dhe kushti kryesor për lidhjen e kontratës së sigurimit. Në kundërshtim me këto përfundime, të bazuara mbi provat e administruara në gjykim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në rrethanat e çështjes (paragrafi 5.1 i vendimit) shprehet se *"nga i padituri fillimisht është pranuar ekzistenca e kontratës dhe për këtë arsye, në ditët e mëvonshme paditësi ka paguar edhe primin e sigurimit, pagesë e cila është bërë në datën 2.7.2007 pranë "First Investment Bank" në Tiranë. Më pas pala e paditur, shoqëria "SIGAL" sh.a., nuk ka pranuar të përmbushë detyrimin që rrjedh nga kontrata e sigurimit, polica e sigurimit"*. Nga vijueshmëria logjike e arsyetimit të vendimit, rezulton se bazuar mbi këtë provë, e cila nuk është administruar në gjykimin e faktit dhe nuk i është nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, Kolegji Civil ka arritur në një konkluzion të ndryshëm nga gjykatat e faktit, pra se kontrata e sigurimit ka hyrë në fuqi dhe, për rrjedhojë, siguruari nuk përjashtohet nga përgjegjësia për të mbuluar apo për të paguar shumën e sigurimit, sipas policës së sigurimit 10/0101 nr. serie 001949, datë 11.4.2007.

20. Gjykata vëren, gjithashtu, se në gjykimin e faktit shoqëria "SIGAL" sh.a., në respektim të parimit të disponibilitetit të palëve në gjykim, ka paraqitur prova për shkeljen e kushteve të kontratës, që lidhen me kryerjen, me veprime apo mosveprime, të shkeljeve ligjore nga ana e të siguruarit, pronarit të anijes, kapitenit të anijes, operatorit përgjegjës dhe menaxherit, përfaqësuesit të klasit (shoqëria klasifikuese - regjistri detar), përfaqësuesit të flamurit etj. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të këtyre provave, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë arritur në përfundimin se anija është mbytur për faj të transportuesit të mallit dhe nga i siguruari nuk janë zbatuar kushtet e kontratës së sigurimit për njoftimin në kohë dhe minimizimin e humbjeve, çka e çliron siguruarin nga dëmshpërblimi. Po ashtu, ato kanë theksuar se kontrata e sigurimit mbulonte vetëm humbjen totale të mallit (*total loss only*) dhe se siguruari ka detyrimin të paguajë vetëm kur malli ka humbur tërësisht dhe s'ka asnjë mundësi për rikuperimin e tij. Në gjykim ka rezultuar e provuar se anija është mbytur 2 milje larg hyrjes së portit, në thellësinë 14 m, dhe ka qenë mundësia që malli të rikuperohej, çka rezulton se është bërë nga pronari i anijes. Në kundërshtim me këto konkluzione të arritura nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, Gjykata e Lartë, pasi ka arritur në konkluzionin se kontrata e sigurimit mes palëve është e vlefshme, është shprehur se gjatë gjykimit nuk ka rezultuar e provuar ndonjë rrethanë për të cilën siguruari mund të shkarkohet nga pagesa e shpërblimit të sigurimit (paragrafi 33 i vendimit të Kolegjit Civil) dhe se parashtrimi i bërë nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me avarinë e anijes transportuese, fajësinë apo pafajësinë e kapitenit të anijes etj. nuk janë objekt i këtij gjykimi (paragrafi 35 i vendimit të Kolegjit Civil). Në kushtet kur Gjykata e Lartë arriti në konkluzionin se kontrata e sigurimit mes palëve kishte hyrë në fuqi dhe se ishte e vlefshme, ajo duhej që të argumentonte se pse në rastin konkret nuk gjenin zbatim dispozitat ligjore që shkarkojnë siguruarin nga përgjegjësia për pagesën e dëmit dhe nuk mund të anashkalonte përfundimet mbi provat dhe rrethanat e ngjarjes, të arritura nga gjykatat e faktit.

21. Në procesin gjyqësor shoqëria "REAL X" sh.p.k. ka pretenduar se me marrëveshje verbale ndërmjet palëve është rënë dakord që primi i sigurimit të paguhet në një kohë të mëvonshme. Po ashtu, ai ka pretenduar se midis shoqërisë "SIGAL" sh.a. dhe shoqërisë "SHEGA TRANS" sh.a., e cila ka rekomanduar që i siguruari të sigurohej pranë siguruarit, ka qenë praktikë (zakon tregtar) që pagimi i primeve të bëhej në një moment të mëvonshëm, në mënyrë kumulative dhe periodike, dhe momenti i hyrjes në fuqi të policës, sipas kësaj praktike, nuk ka qenë asnjëherë i lidhur me pagimin e primit. Në lidhje me këto pretendime, gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë arsyetuar se siguruari nuk e ka pranuar në gjykim ekzistencën e një marrëveshjeje verbale mes palëve dhe, për më tepër, ajo nuk mund



të pranohet, pasi nuk mund të konceptohet vlefshmëria e kontratës së sigurimit pa u paguar primi i sigurimit. Lidhur me pretendimin për ekzistencën e praktikës (zakonit tregtar) ato kanë vlerësuar se një praktikë e tillë, marrëveshje a zakon tregtar, bie në kundërshtim me nenin 1126 të Kodit Civil dhe, për rrjedhojë, një marrëveshje në kundërshtim me ligjin nuk mund të mbrohet nga ai vetë. Edhe në lidhje me këto përfundime të gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë, në kundërshtim me provat e administruara në gjykim, ka arsyetuar se referuar komunikimeve midis palëve ndërgjyqëse, ka rezultuar se siguresi ka qenë dakord për fillimin e pagimit të dëmit për shkak të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, por më pas është tërhequr nga ky qëndrim. Lidhur me zakonin tregtar, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në çështjen në shqyrtim plotësohen kushtet për t'u marrë në konsideratë, me të gjitha pasojat, kjo praktikë tregtare, pasi mes palëve janë zhvilluar praktika të njëjlojta, sistematike dhe të qëndrueshme në lidhje me pagesat e primeve në një kohë të dytë, në mënyrë kumulative.

22. Siç u theksua edhe më sipër, vlerësimi që kryen Gjykata e Lartë, në kuptim të neneve 472 dhe 485 të KPC-së, lidhet me çështjet që kanë të bëjnë me mosrespektimin e ligjit ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, ndaj provave të administruara në gjykimin e faktit dhe që i janë nënshtuar debatit gjyqësor. Individualizimi i provave, të cilat përbëjnë burimin e bindjes së gjyqtarit, dhe administrimi i tyre janë çështje që i përkasin gjykimit të faktit dhe, si të tilla, ndajnë juridiksionin e atyre gjykatave nga ai i Gjykatës së Lartë si gjykatë e ligjit. Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por as nuk mund të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit, t'i ndryshojë ato, apo të arrijë në konkluzione për faktet e çështjes që bien në kundërshtim me përfundimet e gjykatave më të ulëta. Në rastin konkret, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, jo vetëm ka administruar një provë të re (vërtetimi bankar) por, në mënyrë të përsëritur, e ka mbështetur vendimin e tij në fakte e rrethana, të cilat nuk janë pranuar si të vërteta nga gjykatat e faktit dhe ka anashkaluar konkluzionet e këtyre gjykatave mbi provat e administruara në gjykim. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat e saj ligjore, duke cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, si element i të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

23. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimet nr. 34 datë 3.10.2007; nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, e drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur e të caktuar me ligj, kërkon edhe që gjykata t'i krijojë secilës palë të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake, në raport me palën kundërshtare. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues, për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 23, datë 8.6.2007; nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, duke e zgjidhur çështjen mbi bazën e provave dhe fakteve që nuk janë administruar dhe provuar në një gjykim të barabartë dhe në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, si dhe duke bërë një rivlerësim të provave, në një kohë kur kërkuesi jo vetëm nuk kishte të drejtë të diskutonte për to në Gjykatën e Lartë, por dhe nuk ishte i përgatitur për të paraqitur argumentet e veta lidhur me faktet e çështjes, e ka vënë atë në një pozitë të diferencuar në raport me palën tjetër, duke e cenuar në të drejtën e tij për të qenë i barabartë në një gjykim të drejtë dhe të pavarur.

25. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin, nga ana e Gjykatës së Lartë, të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj është i bazuar.

*C. Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

26. Kërkuesi pretendon, gjithashtu, se është cenuar në të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në një masë të konsiderueshme, është jokohorent, kontradiktor, jologjik dhe i paplotë.

27. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Përfundimet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 33, datë 8.12.2005; nr. 8, datë 16.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Vendimet gjyqësore duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk rezulton që vendimi i kundërshtuar të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuarit është i pabazuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,<sup>1</sup>

#### VENDOSI:

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2012-1593 (269), datë 24.5.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha

<sup>1</sup> Gjyqtari S. Berberi votoi pro pranimit të kërkesës edhe për pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë.



**VENDIM**  
**Nr. 28, datë 25.6.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	Anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 7.2.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 50/23 Akti, që i përket:

**KËRKUESE:** Liljana Selishta

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f, dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjo i relatorin e çështjes, Sokol Berberi, shqyrtoi dokumentet e paraqitura dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesja, në cilësinë e paditëses, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadinë me objekt “Pjesëtimin e sendit të përbashkët”. Me vendimin nr. 3877, datë 2.12.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur lejimin e pjesëtimin të sendit të përbashkët, duke i takuar kërkueses 4/20 pjesë ideale në natyrë.

2. Gjykata e Apelit, me vendimin nr. 259, datë 10.9.2009, ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për vazhdimin e gjykimit të çështjes (fazës së dytë të pjesëtimin). Kancelaria e gjykatës e ka bërë me dije kërkuesen se dosja është dërguar për shqyrtim rekursi në Gjykatën e Lartë. Gjatë kohës, duke filluar nga momenti i depozitimit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese (25.6.2012) e deri në momentin e marrjes në shqyrtim të saj nga kjo gjykatë (20.11.2012), Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2012-2215, datë 23.10.2012, ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit të depozituar në datën 28.10.2009. Sipas rregullores së brendshme të Gjykatës së Lartë, disa lloje çështjesh, si pasojë e afateve të shkurtra për gjykim, parashikuar nga legjislacioni në fuqi, apo nevojës për vazhdimin e gjykimit në shkallët e tjera, shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar. Ndër rastet kur Gjykata e Lartë vepron me procedurë të përshpejtuar, përfshihen edhe çështjet e pjesëtimin të pasurisë (faza e parë).

3. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Ajo ka argumentuar se kanë kaluar katër vjet nga momenti i depozitimit të padisë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (28.1.2008) dhe ende nuk ka përfunduar procesi gjyqësor i fazës së dytë të pjesëtimin. Sipas kërkueses, edhe pse dosja ndodhej në Gjykatën e Lartë për shqyrtim rekursi,

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë duhej të vazhdonte me fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë. Bazuar në nenin 451 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), vendimi nr. 3877, datë 2.12.2008 i Gjykatës së Rrethit Tiranë konsiderohet vendim i formës së prerë dhe, sipas nenit 371 të KPC-së, kur vendimi i ndërmjetëm ka marrë formë të prerë, gjykata vazhdon me gjykimin në fazën e dytë.

4. **Subjekti i interesuar**, Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Avokaturës së Shtetit, në parashtrimet me shkrim ka pretenduar se:

4.1 Sipas KPC-së, ndaj vendimit të fazës së parë të pjesëtimit të sendeve në bashkëpronësi, lejohet ankimi i veçantë i cili pezullon vazhdimin e mëtejshëm të gjykimit. Ndaj, me të drejtë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e ka dërguar dosjen në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka vazhduar me fazën e dytë të pjesëtimit;

4.2 Vendimi gjyqësor i Gjykatës së Apelit Tiranë, në rastin konkret, nuk është i formës së prerë, pasi në kuadrin e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe legjislacionit procedural civil, një vendim quhet i formës së prerë vetëm kur është ezauruar gjykimi në Gjykatën e Lartë, në rastet e paraqitjes së rekursit;

4.3 Pretendimet e kërkuësës janë të paargumentuara dhe të pambështetura në fakte dhe për këto arsye duhet të deklarohen haptazi të pabazuara.

## II

### Vlerësimi i Gjykatës

*Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës*

5. Kërkuësja ka argumentuar se mosvazhdimi i gjykimit të çështjes me fazën e dytë të pjesëtimit ka sjellë cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ajo ka pretenduar se mosvazhdimi i gjykimit për një kohë të gjatë, duke filluar nga nxjerrja e vendimit nr. 259, datë 10.9.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka penguar realizimin e të drejtave të saj pasurore.

6. Gjykata, gjatë votimit të çështjes mbi këtë pretendim, për arsye se votat u ndanë në mënyrë të barabartë<sup>2</sup>, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, të kërkuar nga neni 133/2 i Kushtetutës dhe neni 72/1 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Në këto kushte, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ka konkluduar se kjo kërkesë e kërkuësës duhet të refuzohet. Sipas këtij neni, refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuësja të riparqesë kërkesën, në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, germa “a” dhe neni 134, pika 1, germa “f” të Kushtetutës; neni 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

### VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

<sup>2</sup> Votuan për pranimin gjyqtarët: Bashkim Dedja, Sokol Berberi, Admir Thanza, Fatmir Hoxha. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: Vladimir Kristo, Xhezair Zaganjori, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj.



## **KËRKESË**

Shtetasi Xhunejt Shehu, lindur dhe banues në Tiranë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetases Haxhire Shehu, e datëlindjes 5.2.1896.

**KËRKUESI**  
**Xhunejt Shehu**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 1.7.2013  
Doli nga shtypi më 1.7.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 36 lekë